**VENDIM**
**Nr. 999, datë 9.12.2015**

# PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHËTITORES KRYESORE ANËS DETIT, HIMARË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i shëtitores kryesore anës detit, Himarë".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Himarë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme të shpronësimit43 906 145 (dyzet e tre milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 43 906 145 (dyzet e tre milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekësh, si dhe shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitin 2015.
5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Himarë.
7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARE

**TABELA E PRONAREVE TE SHPRONESIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT ''REHABILITIMI I SHETITORES KRYESORE ANES DETIT, HIMARE''**

| Nr | Mbiemer | Emer | Lloj I pasurise | Nr. Hipotekore/Pasurie | Zone Kadastrale | Sip. objektit qe Shpronesohet | Vlera e objektit per Shpronsimet ne Leke | Cmimi I objektit per njesi sipas titullit te shpronesis | Cmimi I tokes se objektit per njesi sipas VKM.nr.514 | Vlera e tokes per Shpronesimet ne Leke | Vlera totale per shpronesimet =vlere e objektit - vlere e tokes ne proporcion me sip. | Vendodhje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Beno | Edmond | Objekt-biznes | 2386 | 1952 | 684 m² | **20880047.2** | Ky cmim eshte llogaritur me koef.amortizimi 11% qe nga viti 2004 pas rikonstruksionit | | | 20880047.2 | Spile,Himare |
| 2 | Gjicali | Fotaq | Objekt-banese | 244 | 1952 | 176 m² | **7490736** | 42561 leke/m2 | 4350 leke/m2 | **765600** | 6725136 | Spile,Himare |
| 3 | Doja | Ferdinant | Objekt-banese | 459 | 1952 | 53.5 m² | **2277013.5** | 42561 leke/m2 | 4350 leke/m2 | **212477.92** | 2064535.58 | Spile,Himare |
| 4 | Doja | Ferdinant | Objekt-banese | 466 | 1952 | 37.8 m² | **1608805.8** | 42561 leke/m2 | 4350 leke/m2 | **184677.1** | 1424128.7 | Spile,Himare |
| 5 | Gjoka | Jorgo | Objekt-banese | 458 | 1952 | 152 m² | **6469272** | 42561 leke/m2 | 4350 leke/m2 | **346608** | 6122664 | Spile,Himare |
| 6 | Gjoka | Kristo | Objekt-banese | 457 | 1952 | 166 m² | **7065126** | 42561 leke/m2 | 4350 leke/m2 | **375492** | 6689634 | Spile,Himare |

SHUMA = **43906145.48**

## PREVENTIV PUNIMESH SIPAS EKB-se

**OBJEKTI:** SPRONESIMI I OBJEKTIT Z. EDMOND BENO

**VENDODHJA:** QYTETI I HIMARES, BASHKIA HIMARE

| Nr | Nr/anal | EMERTIMI I PUNIMEVE | Njes | Sasia | Cmimi | Vlera(leke) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **2-Punime murature dhe betoni** | | | | |
| 1 | 86 | Mur me tulle me 8 vrima, t=12cm, h-3m, llaç perzier M15 | m³ | 80 | 9,008.00 | 720,640.00 |
| 2 | 129/1 | Mur betoni C 12/15 | m³ | 190 | 15,218.00 | 2,891,420.00 |
| 3 | 117/1 | Kollona b/a monolite C - 16/20 | m³ | 120.8 | 17,116.00 | 2,067,955.12 |
| 4 | 122/1 | Soleta b/a me polisterol C18/22.5 | m³ | 180.8 | 15,604.00 | 2,820,891.12 |
| 5 | 109/1 | Themel betoni C-12/15 | m³ | 116.0 | 9,778.00 | 1,134,150.22 |
| 6 | 110/1 | Themel buto betoni C-12/15 | m³ | 95.9 | 8,685.00 | 832,891.50 |
| 7 | 114/1 | Pllake themeli C-16/20 | m³ | 85.2 | 9,104.00 | 775,660.80 |
| | | **Shuma 1** | | | | **11,243,608.76** |
| | | **4-Punime shtresash** | | | | |
| 1 | 362/2 | Shtrese me pllaka majolike e dyshemese te brendshem,wc-ve. | m² | 750 | 2,033.00 | 1,524,750.00 |
| 2 | An | Shtrese me pllaka per ambjent te jashteme | m² | 400 | 2,017.00 | 806,800.00 |
| 3 | An | Veshje me rasa guri | m² | 500.0 | 4,684.00 | 2,342,000.00 |
| 4 | 265 | Shtrese pllaka qeramike me llac | m² | 400 | 1,744.00 | 697,600.00 |
| 5 | An | F.V. Kangjella metalike | m² | 187 | 3,800.00 | 710,600.00 |
| | | **Shuma 2** | | | | **6,081,750.00** |
| | | **5-Punime dyer-dritare** | | | | |
| 1 | An | F.V. dyer druri | m² | 17.0 | 9,725.00 | 165,325.00 |
| 2 | An | Dyer d/alumini dopio xham | m² | 17.0 | 9,889.00 | 168,113.00 |
| 3 | An | Vetrate xhami | m² | 95 | 9,600.00 | 912,000.00 |
| | | **Shuma 3** | | | | **1,245,438.00** |
| | | **6-Punime hidrosanitare** | | | | |
| 1 | 502 | F.V WC cilesi e II | cope | 3 | 8,283.00 | 24,849.00 |
| 2 | 2.495 | F.V lavaman cilesi e II | cope | 3 | 7,993.00 | 23,979.00 |
| | | **Shuma 4** | | | | **48,828.00** |
| | | **SHUMA 1 + SHUMA 2+ SHUMA 3+ SHUMA 4** | | | **18,619,624.76** | |
| | | **Punime Elektrike 5%** | | | **930,981.24** | |
| | | **SHUMA** | | | **19,550,606.00** | |
| | | **T.V.SH. 20%** | | | **3,910,121.20** | |
| | | **SHUMA TOTALE+T.V.SH. 20%** | | | **23,460,727.20** | |